

Karta e Gjenevës e Kombeve të Bashkuara

Mbi Strehimin e Qëndrueshëm

**Garanton të drejtën për strehim të
denjë, të përshtatshëm, të
përballeshëm dhe të shëndetshëm
për të gjithë**





Karta e Gjenevës e Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin e Qëndrueshëm

Kapitulli 1. Sfidat për Strehim të Qëndrueshëm

Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Vendet Anëtare të Evropës thekson se:

1. Strehimi i qëndrueshëm luan një rol kyç në cilësinë e jetës së njeriut. Ndikimi pozitiv i strehimit mund të rritet nëpërmjet zbatimit të parimeve të tilla si: mbrojtja mjedisore; efektiviteti ekonomik; përfshirja dhe pjesëmarrja sociale si dhe përshtatshmëria kulturore. Zhvillimi i strehimit të qëndrueshëm në rajonin e KEE-së (Komisioni Ekonomik për Evropën) përballlet me sfida të shumta, të cilat rrjedhin kryesisht nga globalizimi, ndryshimet demografike, ndryshimet klimaterike dhe kriza ekonomike.

2. Ofrimi i strehimit, menaxhimi dhe prishja e banesave të strehimit, ndikojnë në mjedis; këto procese konsumojnë burimet (tokën, ujin, energjinë dhe materialet e ndërtimit) dhe prodhojnë, për shembull, emetimet e gazit serrë. Për zvogëlimin e këtij ndikimi kërkohet përfshirja e Qeverive dhe shoqërisë civile, si dhe veprime nga ana e KEE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Menaxhimi efektiv i strehimit, investimet për riparime në shkallë të gjerë, me qëllim përmirësimin e performancës mjedisore dhe zhvillimi i mekanizmave financiarë për të përmirësuar aksesin në strehim, duhet të jenë përparësitë e politikës. Përfaqsa gjithëpërfshirëse në ciklin e projektimit, duhet të promovohet si një ndër mënyrat për të reduktuar ndikimin e këtij sektori në mjedis.

3. Një mjedis i degraduar urban, me ajër të ndotur, zhurma, mungesa të hapësirave të gjelbra si dhe mungesa e mundësive për lëvizshmëri (mobilitet), paraqet rrezikshmëri për shëndetin. Kushtet e strehimit kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi shëndetin fizik dhe mendor të popullsisë. Kushtet e varfra të strehimit në mjediset e brendshme, shkaktojnë ose ndikojnë në një sërë sëmundjesh dhe dëmtimesh të parandalueshme të tilla si: sëmundjet të sistemit respirator, të sistemit nervor, kardiovaskular dhe kancerit.

4. Kriza financiare dhe ekonomike e vitit 2008 theksoi rolin jetik që luajnë tregjet e qëndrueshme dhe transparente të strehimit në ekonomi. Si rezultat i krizës, disa prej shteteve përjetuan çekuilibre shqetësuese në tregjet e tyre të pasurive të paluajtshme (banesave) që sollën konfiskim të pronës, të pastrehë, rritje të aksioneve të pasurive të paluajtshme dhe mungesë të strehimit të qëndrueshëm.

5. Grupet e varfra, të disavantazuara dhe vulnerabël të popullsisë¹ mund të përballen me mungesën e strehimit të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm, të strehimit të pashëndetshëm dhe të pasigurt, pengesave fizike, dhe/ose lidhjen me diskriminim dhe përjashtim. Personat, të cilët banojnë në vendbanime nën standardin jetik dhe në zona informale, shpesh përballen me mungesën e ujit të pijshëm, kanalizimet dhe shërbime të tjera publike.

6. Në disa raste, urbanizimi ka çuar në zgjerimin e zonave urbane. Kjo ka sjellë një ndikim negativ mbi vendbanimet aktuale, si dhe ka zvogëluar tokën e disponueshme për përdorime të tjera. Në raste të tjera, urbanizimi ka qenë i pakontrolluar, duke krijuar dhe zgjeruar vendbanime informale, ku banorët e këtyre zonave mund të përballen me mungesën e sigurisë së zotërimit fizik dhe social të pronës dhe infrastrukturës.

7. Fatkeqësitë e natyrës, të tilla si tërmetet, përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës, si dhe fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, kanë sjellë dëme të mëdha ndaj strehimit në të gjithë rajonin e KEE-së dhe paraqesin sfida serioze për qeveritë dhe rajonin. Politikat dhe planifikimet kombëtare shpesh janë të pamjaftueshme për të parandaluar dhe minimizuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë dhe situatat e emergjencës. Popullsisë së prekur duhet t'i ofrohen zgjidhje të përshtatshme për strehim të përkohshëm, dhe nëse është e nevojshme, nëpërmjet asistencës ndërkombëtare dhe humanitare.

8. Ndryshimet klimaterike janë shndërruar në një realitet të prekshëm, me rritjen e temperaturave globale, përmbytjet, stuhitë dhe rrëshqitjet e tokës duke ndikuar në jetën dhe pronën e njerëzve, dhe duke shkaktuar dëme ekonomike dhe sociale për ata. Shtëpitë dhe vendbanimet e njerëzve duhet të ndërtohen në mënyrë të qëndrueshme për të përballuar ngjarje ekstreme të motit, përfshirë ndryshimet klimaterike.

Kapitulli 2. Qëllimi, Synimi dhe Parimet

9. Karta është një dokument jo-ligjërish i detyrueshëm. Qëllimi i Kartës është të mbështesë vendet Anëtare, teksa ato kërkojnë të garantojnë akses të denjë, për strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të shëndetshëm për të gjithë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë uljes së ndikimit që strehimi sjell në mjedis.

10. Synimi i Kartës është të përmirësojë qëndrueshmërinë e strehimit në rajonin e KEE-së nëpërmjet politikave efektive dhe veprimeve në të gjitha nivelet, duke u mbështetur në bashkëpunimin ndërkombëtar, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

11. Karta kontribuon në zbatimin e rëndësishëm të Objektivave të Qëndrueshme të Zhvillimit në Qytete dhe Vendbanimet e Njerëzve² si dhe në zbatimin e Kuadrit të Strategjisë Globale të Strehimit të Kombeve të Bashkuara³.

12. Ndërsa adresojmë sfidat e nënvizuara në Kapitullin e parë, katër parimet e mëposhtme dhe shkaqet përkatëse formojnë bazën e strehimit të qëndrueshëm:

- (a) Mbrojtja mjedisore;
- (b) Efektiviteti ekonomik;
- (c) Përfshirja sociale dhe pjesëmarrja ;
- (d) Përshtatshmëria kulturore.

(a) Mbrojtja mjedisore

13. Strehimi duhet të planifikohet, ndërtohet dhe shfrytëzohet në atë formë që të minimizojë ndikimin mjedisor dhe të promovojë qëndrueshmërinë mjedisore. Kjo duhet të adresohet përmes:

- (i) Praktikave të strehimit, të cilat ndikojnë në reduktimin e gjurmëve të karbonit në ndërtesa përgjatë gjithë ciklit të tyre të jetës, nga projektimi, furnizimi me material, prodhimi, ndërtimi, e deri tek përdorimi, mirëmbajtja, meremetimi dhe shkatërrimi;
- (ii) Performancës së përmirësuar mjedisore dhe të energjisë në banesave, duke kontribuar në reduktimin e varfërisë

energjetike, përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët dhe reduktimin e problemeve shëndetësore;

- (iii) Vendbanime urbane të qëndrueshme, të cilat, kur është e mundur, të përdorin energjinë e rinovueshme dhe në mënyrë pro-aktive të marrin në konsideratë ndryshimet klimaterike;
- (iv) Përdorimit të banesave të riparuar sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim përdorimin efikas të burimeve;
- (v) Përdorimit të grupit të banesave, të cilat janë të qëndrueshme ndaj rreziqeve natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriut, duke u zgjeruar nëpërmjet planifikimit të përshtatshëm, projektimit dhe ndërtimit të sigurt;
- (vi) Hapësirave të gjelbra përreth dhe brenda zonave të banimit, duke përfshirë fusha që ofrojnë vendbanim për kafshë të egra, hapësirë për t'u shfrytëzuar gjatë kohës të lirë, për sport dhe për bujqësi urbane;
- (vii) Vendbanime strehimi kompakte sipas një zgjerimi të planifikuar me qëllim parandalimin e zgjerimit urban;
- (viii) Vendbanime strehimi duke i dhënë përparësi sistemeve të qëndrueshme dhe të integruara të transportit si dhe ofrimin e infrastrukturës së gjelbër;
- (ix) Inkurajimi i mënyrë së shëndetshme të jetesës nëpërmjet: projektimit të saktë të strehimit; mirëmbajtjes dhe meremetimit;
- (x) Menaxhimit të mbetjeve të trajtuara si një pjesë përbërëse të strategjive të strehimit të qëndrueshëm, duke përfshirë ndërtimin e banesave, shkatërrimin e shtëpive dhe dhomës së ndenjes së banesës, duke nxitur ri-përdorimin, riciklimin dhe kompostimin.

(b) Efektiviteti ekonomik

14. Strehimi është, dhe ka qenë, një sektor me ndikim të madh në ekonominë kombëtare. Strehimi duhet të konsiderohet si një element i qëndrueshëm për një ekonomi me nivel të lartë, gjithashtu dhe një sektor, i cili përmbush nevojat e njerëzve. Kjo duhet të adresohet përmes :

- (i) Pronësisë së sigurt dhe të përcaktuar (d.m.th. të qenit fleksibël ndërmjet zotërimit dhe marrjes me qira të vendbanimit);
- (ii) Informacione kadastrale dhe informacione për regjistrimin e truallit dhe shërbime që mbështesin një mjedis të favorshëm për investime në strehim dhe nxitjen e pronësisë së sigurt të truallit dhe vendbanimit;
- (iii) Mbajtjes së llogarive në mënyrë efektive dhe efikase, procedura rregullatorë dhe norma hipotekare transparente, me qëllim garantimin e disponueshmërisë së saktë të hipotekës, mbrojtjen e konsumatorit, rritjen e sigurisë së strehimit të tyre, zgjerimin e mundësive për strehim, dhe zvogëlimin e rrezikut nga humbja e shtëpive;
- (iv) Rritjes së investimeve për strehimin e qëndrueshëm, përmes investimeve private dhe publike, duke përfshirë partneritetin publik-privat dhe instrumente të tjerë financiarë;
- (v) Ndërtimit dhe rinovimit të vendbanimit, si dhe meremetimit të blloqeve të ndërtesave ekzistuese, për të luftuar varfërinë energjetike duke promovuar eficiencën në energji (e cila gjithashtu, do të ndikojë në zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimaterike);

(vi) Përdorimit të kodeve dhe standardeve të ndërtimit si bazë për ndërtimin e banesave/vendbanimeve, të cilat nxisin harmonizimin e praktikave, procedurave dhe specifikimeve të produkteve të përbashkëta, duke garantuar pajtueshmërinë brenda të gjithë kufijve shtetëror dhe duke garantuar sigurinë e ndërtesave;

(vii) Ndërtimi i blloqeve të strehimit duhet, sa më shumë të jetë e mundur, të mbështetet në përdorimin e materialeve lokale, gjatë projektimit, ndërtimit, mobilimit dhe mirëmbajtjes, duke kontribuar në këtë mënyrë në punësimin lokal;

(viii) Meremetimi i banesave ekzistuese duke përdorur teknologjitë e përshtatshme, në mënyrë që të nxitin punësimin;

(ix) Infrastrukturë dhe shërbime për njerëzit me të ardhura të pakta dhe banesa informale, kur është e mundur dhe e përshtatshme;

(x) Politika dhe programe kombëtare të cilat inkurajojnë, kur është e mundur dhe e përshtatshme, banorët e ndërtesave informale të rregullojnë dhe përmirësojnë ndërtimet e tyre, duke garantuar që vendndodhja gjeografike dhe faktorët e tjerë të sigurojnë përmbushjen e kriterëve minimale të sigurisë;

(xi) Rigjenerim dhe zhvillim më të integruar urban, me vende pune dhe shërbime, të cilat lidhen ngushtësisht me strehimin, ndërkohë që duhet të merren në konsideratë rreziqet potenciale dhe dëmtimet e mundshme;

(xii) Planifikimit hapësinor që përfshin politika si: shpërndarja e veprimtarive ekonomike në mënyrë efikase, përmirësimi i infrastrukturës teknike, sociale dhe shërbimeve; ndërmarrja e rigjenerimit urban; ofrimi i strehimit të përballueshëm dhe adresimi i shtrirjes urbane.

(c) Përfshirja sociale dhe pjesëmarrja

15. Politika dhe debati mbi strehimin duhet të përmirësohet duke vënë theksin në angazhimin e përfshirjes qytetare, përfshirjen sociale, shëndetin publik, transparencën dhe interesimin e proceseve etike. Kjo mund të adresohet si më poshtë:

(i) Instrumentet e mbështetjes nga shteti për një strehim të përshtatshëm, të shëndetshëm, të sigurt dhe të përballueshëm, duke përfshirë këtu aksesin ndaj shërbimeve bazë dhe publike, të cilat nxisin kohezionin social dhe kontribuojnë në përmbushjen e nevojave për strehim të grupeve të ndryshme sociale, përfshirë grupet dhe njerëzit e marginalizuar dhe vulnerabël⁴;

(ii) Rritja e disponueshmërisë së alternativave për strehim, në veçanti strehimin e përballueshëm dhe social, nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm, duke përfshirë nxitjen e asnjësisë, në lidhje me pronësinë e banesës;

(iii) Planifikimi, projektimi, mirëmbajtja dhe meremetimi në strehim duhet të promovojë jetesë të shëndetshme; inkurajojë zbatimin e parimeve universale në projektim me qëllim rritjen e përdorimit/shfrytëzimit të shtëpive për të gjithë grupet e njerëzve pavarësisht brezave, gjinive, apo aftësive të kufizuara; si dhe të inkurajojë komunitetet e përziera sociale;

(iv) Mbështetje për zgjidhje të përshtatshme strehimi, për njerëzit, të cilët janë të prekur nga fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore;

(v) Politika strehimi dhe politika për pronësinë e truallit, të cilat mbështesin drejtësinë sociale;

(vi) Zhvillimi i politikave kombëtare të strehimit, përmes proceseve vendimmarrëse demokratike, të bazuara në njohuritë e ekspertëve, koleksionit të gjerë të dhënave, raporteve transparente statistikore, si dhe debateve të gjera publike dhe gjithëpërfshirëse, në lidhje me të gjitha aspektet e zhvillimit të strehimit;

(vii) Hulumtimi dhe shkëmbimi i njohurive për të gjitha aspektet e strehimit të qëndrueshëm;

(viii) Qeverisje në mënyrë efektive, të qartë dhe transparente në të gjitha nivelet, duke përfshirë procedurat e institucionalizuar për ankesat ndaj vendimeve që kanë të bëjnë me strehimin.

(d) Përshtatshmëria kulturore

16. Politikat e strehimit duhet të marrin në konsideratë çështjet lidhur me identitetin kulturor, vlerën kulturore dhe mirëqenien emocionale. Kjo mund të adresohet nëpërmjet:

(i) Politikave kombëtare të strehimit, të cilat marrin parasysh veçantitë sociale dhe territoriale, mbështesin mbrojtjen dhe rritjen e peizazheve; trashëgiminë kulturore dhe historike.

(ii) Duke vënë theksin mbi zhvillimin e hapësirave publike për veprimtaritë kulturore dhe sociale;

(iii) Strehimi duhet të marrë në konsideratë, prejardhjen dhe kulturën e banorëve;

(iv) Banesat dhe lagjet e projektuara, duhet të mirëmbahen në mënyrë aktive, në mënyrë që të rrisin mirëqenien emocionale të njerëzve, duke përfshirë angazhimin e komunitetit lokal në këtë proces.

Kapitulli 3. Drejtimit kryesore të punës dhe masat për promovimin e strehimit të qëndrueshëm

17. Shtetet Anëtare kanë për qëllim të përparojnë drejt strehimit të qëndrueshëm në katër drejtimit kryesore si më poshtë:

(a) Kufizimi i ndikimit negativ që sjell strehimi në mjedis dhe nxitja e efiçencës së energjisë në sektorin e strehimit;

(b) Nxitja e aksesit në strehimit, në kontekstin e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm;

(c) Nxitja e strehimit të denjë, të përshtatshëm, të shëndetshëm, pa pengesa dhe të sigurt;

(d) Promovimi i zbatimit të parimeve për një strehim të qëndrueshëm;

18. Vendet Anëtare mbështesin masat si vijojnë:

(a) Kufizimin e ndikimit negativ që sjell strehimi në mjedis dhe nxitjen e efiçencës së energjisë në sektorin e strehimit duke marrë masat e mëposhtme:

- (i) Zvogëlimi i gjurmëve të karbonit në sektorin e strehimit duke ulur përdorimin e energjisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndërtesave, duke përfshirë: proceset e projektimit të ndërtesave për strehim, furnizimit me materiale dhe prodhimin e tyre; ndërtimin; mirëmbajtjen; mobilimin dhe shkatërrimin;
- (ii) Zvogëlimin e ndikimit negativ mjedisor për frymë në qytete, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve;
- (iii) Aplikimi i kodeve dhe standardeve të ndërtimit për efikasitetin e energjisë dhe sigurinë mjedisore për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese të banimit;
- (iv) Rritja e përqindjes së njësive të strehimit më kosto të ulët energjie, si pjesë e një përqasje të integruar për rigjenerimin urban;
- (v) Rritja e përdorimit të teknologjive të karbonit të ulët dhe të energjisë së rinovueshme në strehim;
- (vi) Meremetimi dhe rinovimi i blloqeve ekzistuese të banesave, duke respektuar mjedisin, efikasitetin e energjisë, të përbalueshme dhe kosto-efektive; duke shfrytëzuar zgjidhjet dhe njohuritë lokale kur është e mundur;
- (vii) Zbatimi i strategjive për të garantuar se projektimi dhe ndërtimi i banesave është në zbatim me parimet e qëndrueshmërisë mjedisore, me interes të veçantë ndaj reduktimit dhe adaptimit të ndryshimeve klimaterike;
- (viii) Përvetësimi i politikave të gjelbra në strehim dhe integrimi i tyre në politikat e zhvillimit të qëndrueshëm urban të territorit;
- (ix) Përfshirjen e menaxhimit të mbetjeve dhe ujit, si një pjesë përbërëse e strategjive dhe politikave për strehim të qëndrueshëm;
- (x) Inkurajimit për ndërtimin e banesave të strehimit për shumë familje, duke promovuar transportin e integruar urban dhe mundësuar përdorimin e automjeteve të pastra, kryesisht për të eliminuar shtrirjen urbane dhe për të kursyer energji;
- (xi) Sigurimi i duhur financiar dhe teknik për të mbështetur palët e interesuara, në veçanti për të siguruar realizueshmërinë dhe përbalueshmërinë duke ofruar këto ndërtesave me efikasitetin e energjisë, duke përfshirë në to grupet më në nevojë të shoqërisë;
- (xii) Promovimi dhe monitorimi i rigjenerimit dhe zhvillimit urban të integruar, të cilat i afrojnë vendet e punës dhe shërbimet më pranë hapësirës së strehimit, duke marrë parasysh rreziqet dhe dëmtimet e mundshme ; si dhe përmirësimin e kushteve ndaj ndryshimeve klimaterike;
- (xiii) Sigurimi i qasjeve universale të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, sipërfaqe publike të gjelbra, veçanërisht për grupet e pafavorizuara⁵.

(b) Nxitjen e aksesit në strehim në kontekstin e zhvillimit të

qëndrueshëm ekonomik, duke ndërmarrë masat e mëposhtme

- (i) Garantimi i aksesit për të gjitha banesat e përshtatshme, të sigurta dhe të përballueshme dhe ofrimin e shërbimeve bazë ;⁶
- (ii) Nxitja e pronësisë së sigurt dhe disponueshmëria e opsioneve të strehimit, duke përfshirë trajtimin asnjans për sa i përket pronësisë (si për shembull zotërimin e banesës apo marrjen me qira), me qëllim inkurajimin e zhvillimit të pajisjeve të përshtatshme të strehimit të përballueshëm;
- (iii) Nxitja e tregjeve të qiramarrjes, transparente dhe të ndershme, duke vendosur një balancë ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve mes pronarëve dhe qiramarrësve, përmes kuadrit të saktë ligjor dhe mekanizmave për zgjidhjen e konflikteve, duke përmirësuar lëvizshmërinë (mobilitetin) e banimit dhe të punës;
- (iv) Dhënien e kontributit për mirë-funksionimin, efikasitetin, paanshmërinë dhe transparencën e tregjeve të strehimit dhe tregjeve të truallit, të cilat i referohen llojeve të ndryshme të kërkesës së strehimit, si dhe favorizimin e marrjes së kredive për grupet e disfavorizuara të popullsisë në aspektin social dhe ekonomik, duke përfshirë forma të tjera alternative financimi, të tilla si kredi të vogla për strehimin;
- (v) Zhvillimin dhe rishikimin e politikave dhe procedurave për ripërtëritjen e integruar urbane dhe mirëmbajtjen e banesave, duke përfshirë sistemet e shërbimit dhe inkurajimin e investimeve të gjelbra në këtë sektor;
- (vi) Nxitja e menaxhimit efektiv të stokut të banesave dhe zhvillimi i mekanizmave për rinovimin e përballueshëm të banesave të strehimit;
- (vii) Nxitja e investimeve për strehimin e qëndrueshëm nëpërmjet investimeve private dhe publike, partneritetit publik-privat dhe formave të tjera të investimit;
- (viii) Zhvillimin e programeve, kur është e përshtatshme, për të asistuar personat që janë të rrezikuar ndaj mos-shlyerjes së kredisë, për shkak të goditjeve sociale apo ekonomike, të cilët kërcënohen nga mbetja të pastrehë’
- (viii) Zhvillimi i kuadrit ligjor për të garantuar të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pronarëve të pronës si dhe qiramarrësve;

Kur është e mundur dhe e përshtatshme, të ndihmohen me akses në infrastrukturë dhe shërbime të përshtatshme, personat të cilët jetojnë në banesa informale, apo banesa me ardhura të pakta;
- (ix) Promovimi i politikave dhe programeve kombëtare, të cilat, kur është e mundur dhe e përshtatshme, nxisin banorët e ndërtesave informale për të rregulluar dhe përmirësuar ndërtimet e tyre, duke pasur në konsideratë se vendndodhja gjeografike dhe faktorë të tjerë, lejojnë përmbushjen e kriterëve minimale të sigurisë;
- (xii) Nxitja e përdorimit të zgjidhjeve efçente për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe mirëmbajtjen e strehimit të qëndrueshëm, duke respektuar në veçanti elementet kulturore

- dhe gjeografike të Vendeve Anëtare;
- (xiii) Krijimi i rregulloreve dhe procedurave efektive, të qarta dhe transparente, si dhe krijimi i institucioneve të duhura për nxjerrjen e lejeve të ndërtimit, me për të siguruar drejtësi, mos-diskriminim, si dhe luftimin e korrupsionit në këtë sektor;

Promovimi i informacionit hapësinor, kadastral dhe regjistrimit të tokës, si dhe nxitja e shërbimeve për të krijuar një mjedis të favorshëm për investime, në sektorin e strehimit, sigurimit të truallit dhe pronësisë.

Mbështetja e qyteteve dhe vendbanimeve për t'u përshatur dhe për të zbatuar koncepte të një qyteti të zgjuar, politika të integruara dhe plane të cilat mbështesin: gjithpërfshirjen dhe komunitet e përziera sociale; efikasitetin e burimeve; dhe qëndrueshmërinë nga ndryshimet klimaterike dhe fatkeqësitë⁷

- (xiv) Promovimi i planifikimit të integruar hapësinor, i cili mbështet: shpërndarjen efikase hapësinore të veprimtarive ekonomike; përmirësimin infrastrukturor teknik dhe social; rigjenerimin dhe rilindjen e integruar urbane ; si dhe strehim të përbalueshëm i cili gjithashtu adreson zgjerimin urban.

(c) Promovimi i strehimit të denjë, të përshtatshëm, të shëndetshëm, pa pengesa dhe të sigurt, duke ndërmarrë masat në vijim:

- (i) Përmirësimi i aksesit për të gjithë, për një strehim cilësor dhe të shëndetshëm, ulja e numrit të pastrehëve dhe përmirësimi i aksesit në strehim pa pengesa;
- (ii) Zhvillimi i komuniteteve të përziera sociale dhe shmangia e ndarjes sociale, gjinore, dhe komuniteteve të izoluara;
- (iii) Nxitja e jetesës së shëndetshme përmes projektimit të strehimit, mirëmbajtjes dhe meremetimit, si dhe nëpërmjet hapësirave publike dhe të gjelbra, përreth zonave të strehimit;;
- (iv) Përmirësimi i qëndrueshmërisë së ndërtesave nga dëmet e shkaktuara nga njeriu apo natyra, përmes planifikimit, projektimit dhe ndërtimit të sigurt;
- (v) Zhvillimi i strategjive të qëndrueshme për strehim, të cilat përmirësojnë aksesin ndaj shërbimeve publike bazë përfshirë ujë të pijshëm dhe kanalizimet;
- (vi) Nxitja e përdorimit të parimeve universale në projektim, për të rritur aksesin për një strehim të përbalueshëm dhe aftësinë për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gjithë;
- (vii) Të sigurojnë se politikat e strehimit dhe legjislativi, si dhe zbatimi i tyre të jenë jo-diskriminues.

(d) Promovimi i zbatimit të vazhdueshëm të parimeve të qëndrueshme të strehimit, duke ndërmarrë masa për:

- (i) Mbledhjen e të dhënave mbi strehimin, përfshirë të pastrehët, duke përdorur standardet ndërkombëtare për të siguruar krahasueshmërinë e të dhënave me shtetet anëtare; vënia e këtyre të dhënave statistikore në dispozicion për publikun, në mënyrë që të mbështesi politikbërjen, hulumtimin dhe

- zhvillimin ekonomik; si dhe përdorimin e bazave të të dhënave globale dhe rajonale për të mbështetur procesin e politik-bërjes;
- (ii) Nxitjen e investimeve në fushën e kërkimit dhe inovacionit në të gjitha aspektet e strehimit të qëndrueshëm;
 - (iii) Mbështetje e një qeverisjeje të mirë në të gjitha nivelet e bashkëpunimit ndërmjet agjensive përkatëse qeveritare të vendeve, pjesëmarrje efektive publike në vendim marrje si dhe sundimi i ligjit në sektorin e strehimit;
 - (iv) Zhvillimin e kapaciteteve për pjesëmarrje në planifikimin dhe menaxhimin e interguar dhe të qëndrueshëm të banesave;
 - (v) Intensifikimin e shkëmbimit rajonal dhe ndërkombëtar të përvojës dhe bashkëpunimin në sektorin e strehimit, planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës;
 - (vi) Zhvillimin dhe zbatimin e programeve për ngritjen e kapaciteteve për çështjet e strehimit, planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës, për të gjitha palët e interesuara.

-
1. Përkufizimi i grupeve dhe njerëzve vunerabël, ndryshon nga njëri shtet në tjetrin dhe mund të përfshijë: të rinjtë; të moshuarit; familjet e mëdha me shumë fëmijë dhe familje me një prind; viktimat e dhunës në familje; personat me aftësi të kufizuara duke përfshirë sëmundjet mendore, aftësi të kufizuara intelektuale dhe/ose fizike; emigrantët; refugjatët; komunitetet e popullsisë Rome; si dhe grupe të tjera të minoriteteve.
 2. Prezantim i propozimit të Grupit Publik të Punës mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm datë 19 korrik 2014. Dokumenti <http://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/4518outcomedocument.pdf>
 3. Referojuni dokumentit HSP/GC/24/2/Add.6 ndërsa për vendimet përkatëse referojuni dokumentit, <http://unhabitat.org/wp-content/uploads/2014/02/Decisions-and-resolution-GC-24thsession.pdf>
 4. Përkufizimi i grupeve dhe njerëzve vunerabël, ndryshon nga njëri shtet në tjetrin dhe mund të përfshijë: të rinjtë; të moshuarit; familjet e mëdha me shumë fëmijë dhe familje me një prind; viktimat e dhunës në familje; personat me aftësi të kufizuara duke përfshirë sëmundjet mendore, aftësi të kufizuara intelektuale dhe/ose fizike; emigrantët; refugjatët; komunitetet e popullsisë Rome; si dhe grupe të tjera të minoriteteve.
 5. Prezantim i propozimit të Grupit Publik të Punës mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm datë 19 korrik 2014. Dokumenti: <http://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/4518outcomedocument.pdf>
 6. Ibid (latin:po aty)
 7. Prezantim i propozimit të Grupit Publik të Punës mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, datë 19 korrik 2014. Dokumenti: <http://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/4518outcomedocument.pdf>

